




# Parimet e OBZHE-së mbi Qeverisjen e Ujërave

I miratuar nga Komiteti i Politikave të Zhvillimit Rajonal të  
OBEZH (OECD) më 11 maj 2015

Mirëpritur nga Ministrat në takimin e Këshillit Ministror të  
OBZHE-së më datë 4 qershor 2015

Qendra për Ndërmarrësi, NVM, Rajonet dhe Qytetet



## Pse Parimet e OBZHE-së mbi qeverisjen e ujërave?

### Një perspektivë e zymtë për ujin, që shtron nevojën e të bërit me mirë me më pak

Trysnia globale mbi ujërat dhe sektorët përkatës në të gjithë botën, bën thirrje për veprim:

- Ujërat e ëmbla të aksesueshme dhe të cilësisë së lartë janë një burim i kufizuar dhe tejet i luhatshtëm. Parashikimet e OBZHE-së tregojnë se 40% e popullsisë së botës do të jetojë në pellgje lumi të stresuar deri në vitin 2050, dhe se kërkesa për ujë do të rritet me 55% deri në vitin 2050 (OECD, 2012a).
- Mbishfrytëzimi dhe ndotja e mjediseve ujore (akuiferëve) në mbarë botën paraqet sfida të mëdha për sigurinë e ushqimit, shëndetin e ekosistemeve dhe furnizimin me ujë të pijshëm të sigurt, si dhe, mes pasojave tjera, pritet të rrisë rrezikun e rrëshqitjeve dhe erozionit.
- Parashikohet që në vitin 2050, 240 milionë njerëz nuk do të kenë akses ndaj ujit të pastër, ndërsa 1.4 miliard nuk do të kenë kanalizime dhe shërbimet bazë të higjenes.
- Infrastruktura ujore në zonën e OBZHE-së po amortizohet, teknologjia është e vjetëruar dhe sistemet e qeverisjes shpesh janë të pajisura dobët për trajtimin e kërkesave në rritje, sfidave mjedisore, urbanizimin e vazhdueshëm, ndryshimet klimaterike dhe katastrofat ujore.
- Nevojiten investime të mëdha për të ripërtërirë dhe përmirësuar infrastrukturën për furnizimin me ujë dhe kanalizime, që deri në vitin 2050 vlerësohet të jenë rreth 6.7 trilionë dollarë, ndërkohë që përfshirja e një spektri më të gjerë të infrastrukturës që lidhet me ujërat, do ta trefishonte këtë shumë/faturë deri në vitin 2030 (OBZHE, 2015c).

### Uji, një sektor i fragmentuar

Sektori i ujit ka karakteristika të brendshme që e bëjnë atë shumë të ndjeshëm dhe të varur nga nivelet e shumta qeverisëse.

- Uji ndërlidh sektorë të ndryshëm, vende dhe njerëz, si dhe hapësira gjeografike dhe kohore. Në shumicën e rasteve, kufijtë hidrologjikë dhe ato administrativë nuk përkojnë.
- Menaxhimi i ujërave të ëmbla (sipërfaqësore dhe nëntokësore) është një shqetësim si global ashtu edhe lokal, duke qenë se përfshin në vendimmarrje, politika dhe në ciklet e projekteve, një numër të madh aktorësh publik, privat dhe jofitimprurës.
- Sektori i ujërave është një sektor intensiv dhe monopolist për sa i përket kapitalit, me dështime të rëndësishme të tregut ku koordinimi është thelbësor.
- Politika e ujërave është komplekse dhe e lidhur ngushtë me fusha që janë kritike për zhvillimin, duke përfshirë shëndetësinë, mjedisin, bujqësinë, energjinë, planifikimin hapësinor, zhvillimin rajonal dhe zbutjen e varfërisë.
- Në nivele të ndryshme, vendet kanë kaluar përgjegjësi gjithnjë e më komplekse dhe intensive mbi burimet ujore, tek qeverisjet rajonale apo lokale, duke rezultuar në ndërvarësi në të gjitha nivelet e qeverisjes që nevojitet të koordinohen për të zbutur fragmentimin.


Përballja me sfidat e ardhshme të ujërave ngre jo vetëm pyetjen se "çfarë duhet të bëjmë?", por edhe "kush bën çfarë?", "pse?", "në cilin nivel të qeverisjes?" dhe "si?". Përgjigjet politike do të jenë të frytshme vetëm nëse janë koherente, nëse aktorët angazhohen si duhet, nëse ekzistojnë korniza rregullatore të mirëprojektuara, nëse ekziston informacioni i duhur dhe i aksesueshëm, dhe nëse ka kapacitete të mjaftueshme, integritet dhe transparencë.

Për t'u përgatitur për të ardhmen, institucionet duhet të përshtaten me ndryshimin e rrethanave, ndërkohë që vullneti politik dhe vazhdimësia e politikave janë thelbësore për tranzicionin drejt praktikave më gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

## Krizat e ujit shpesh janë kryesisht kriza të "qeverisjes"

Që nga viti 2010, OBZHE-ja ka ofruar dëshmi mbi boshllëqet kryesore të qeverisjes që pengojnë hartimin dhe zbatimin e politikave të ujërave, dhe ka sugjeruar një paketë reagimesh politike dhe praktikash të mira për tejkalimin e tyre. "Korniza Qeverisëse Shumë-Nivelëshe e OBZHE-së: Kushtojini Rëndësi Boshllëqeve, Tejkaloji Boshllëqet" u zhvillua si një kornizë analitike dhe si një instrument për politikëbërësit, që të mund të identifikonin dhe kapërcenin sfidat e qeverisjes që ndikojnë, në masë më të madhe apo më të vogël, në të gjitha vendet, pavarësisht mjedisit të tyre institucional, disponueshmërisë së ujit ose shkallës së decentralizimit.

### Korniza qeverisëse shumë-nivelëshe e OBZHE-së: Kushtojini rëndësi boshllëqeve, tejkaloji boshllëqet



Burimi: OBZHE (2011), Qeverisja e ujërave në OBZHE: Një qasje shumë-nivelëshe (Water Governance in OECD: A Multi-Level Approach), Botim i OBZHE-së, Paris

Kjo kornizë analitike është përdorur për të shqyrtuar organizimin e qeverisjes së ujërave në 17 vende të OBZHE-së (2011) dhe në 13 vende të Amerikës Latine (2012), si dhe për të zhvilluar diskutime të thelluara të politikave kombëtare me aktorë të shumtë, në mbështetje të reformave të ujit në Meksikë (2013), Holandë (2014), Jordani (2014), Tunizi (2014) dhe Brazil (2015). Po ashtu, janë zhvilluar njohuri tematike dhe udhëzime mbi politikat e angazhimit të aktorëve, menaxhimin e ujërave urbane, si dhe qeverisjen e institucioneve rregullatore në fushën e ujërave (2015).



Të dhënat e OBZHE-së tregojnë se nuk ekziston një zgjidhje unike dhe njësoj e përshtatshme për të gjitha sfidat e ujërave në të gjithë botën, por ekziston një larmi e madhe problematikash brenda dhe përtej vendeve të ndryshme. Për këtë arsye, përgjigjet e qeverisjes duhet të përshtaten me specifikat territoriale, dhe, duke ditur se qeverisja është thellësisht e varur nga konteksti, është tejet e rëndësishme që politikat e ujit t'i përshtaten vendit përkatës.

Peizazhi i qeverisjes për menaxhimin e ujërave të ëmbla ka ndryshuar në 25 vitet e fundit. Informacionet rrjedhin më lirshëm dhe potencialisht nxjerrin në pah më shumë mangësitë, dështimet dhe praktikatat e dobëta. Decentralizimi ka rezultuar në mundësi për të modifikuar politikat në përputhje me realitetet vendore, por edhe ka ngritur sfida të kapaciteteve dhe koordinimit në ofrimin e shërbimeve publike. Tani dihet se vendimmarrja gjithëpërfshirëse nga poshtë-lart është çelësi i politikave efektive të ujërave. Përveç kësaj, një sërë kornizash ligjore kanë nxitur ndryshime të mëdha në politikën e ujërave; megjithatë, zbatimi i tyre ka hasur në pengesa të qeverisjes, siç është rasti i Direktivës Kornizë të Ujërave të BE-së, e cila ka nxitur propozimin e shumë rekomandimeve të mëpasshme, si Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara dhe Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, të datës 28 korrik 2010, të titulluar "E drejta e njeriut për ujë dhe kanalizime".

Së fundmi, por jo për nga rëndësia, zbatimi i konceptit të "Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore" ka sjellë rezultate të pabarabarta brenda dhe mes vendeve, pasi kërkon një kuadër operacional që merr parasysh ndikimet në terma afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, në mënyrë konsistente dhe të qëndrueshme. Nga pikëpamja e sfidave të tilla të zbatimit, Parimet përpiqen të ndihmojnë qeveritë në të gjitha nivelet që të forcojnë qeverisjen e ujërave për t'u përshtatur me sfidat aktuale dhe të ardhshme të ujërave.

## Parimet e OBZHE-së mbi qeverisjen e ujërave: për çfarë?


### Nevoja për politika të forta publike për t'u përgatitur për të ardhmen

Përballja me sfidat aktuale dhe të ardhshme, kërkon politika të forta publike, që mundësojnë objektiva të matshëm në afate kohore të para-përcaktuara në shkallën e duhur, duke u mbështetur në caktimin e qartë të detyrave të të gjithë autoriteteve përgjegjëse, të cilët duhet t'i nënshtrohen monitorimit dhe vlerësimit të rregullt. Qeverisja e ujërave mund të kontribuojë në masë të madhe në hartimin dhe zbatimin e politikave të tilla, duke ndarë përgjegjësitë mes të gjitha niveleve të qeverisjes, shoqërisë civile, biznesit dhe një spektri të gjerë aktorësh që kanë rol të rëndësishëm së bashku me politikëbërësit në vjeljen e përfitimeve ekonomike, sociale dhe mjedisore të qeverisjes së mirë të ujërave.


Parimet e OBZHE-së mbi qeverisjen e ujërave argumentojnë se sistemet e qeverisjes së ujërave duhet të jenë të projektuara në përputhje me sfidat që duhet të mbulojnë. Kjo qasje e zgjidhjes së problemeve do të thotë se "format" e qeverisjes së ujërave duhet të ndjekin "funksionet" e qeverisjes së ujërave. Strukturimi, institucionalizimi dhe/ose formalizmi i institucioneve nuk duhet të devijojë nga objektivi për të ofruar ujë të mjaftueshëm të cilësisë së mirë, ndërsa ruhet dhe përmirësohet integriteti ekologjik i mjedisëve ujore. Parimet e OBZHE-së mbi qeverisjen e ujërave kanë për qëllim të kontribuojnë në hartimin e politikave publike të prekshme dhe të orientuara drejt rezultateve, duke u bazuar në tre dimensione reciprokisht përforcuese dhe plotësuese të qeverisjes së ujërave:

- **Efektiviteti** ka të bëjë me kontributin e qeverisjes në përcaktimin e qëllimeve dhe objektivave të qarta dhe të qëndrueshme të politikave të ujit në të gjitha nivelet e qeverisjes, në zbatimin e këtyre qëllimeve si dhe në përmbushjen e objektivave të pritura.
- **Efikasiteti** ka të bëjë me kontributin e qeverisjes për të maksimizuar përfitimet e menaxhimit të qëndrueshëm të ujërave dhe mirëqenien, me kosto sa më të vogla për shoqërinë.
- **Besimi dhe angazhimi** kanë të bëjnë me kontributin e qeverisjes për të rritur besimin e publikut dhe për të siguruar përfshirjen e aktorëve nëpërmjet legjitimitetit demokratik dhe drejtësisë për shoqërinë në përgjithësi.

## Përmbledhje e parimeve të OBZHE-së mbi qeverisjen e ujërave



Parimet e OBZHE-së mbi Qeverisjen e Ujërave pritet të kontribuojnë në përmirësimin e "Ciklit të Qeverisjes së Ujërave", nga hartimi i politikave tek zbatimi i tyre.



Burimi: Dokumenti i ardhshëm i punës i OBZHE-së, 2015, Treguesit e qeverisjes së ujërave

## Qeverisja, kusht për hartimin dhe zbatimin e suksesshëm të politikave të ujërave

Parimet e OECD-së për qeverisjen e ujërave janë zhvilluar mbi premisën se nuk ka një zgjidhje të vetme për sfidat e ujit në mbarë botën, por një listë opsionesh të mbështetura në shumëllojshmërinë e sistemeve ligjore, administrative dhe organizative brenda dhe ndërmjet shteteve. Parimet reflektojnë faktin se qeverisja është tejet kontekstuale, se politikat e ujit duhet të jenë të përshtatura për vendet dhe burimet e ndryshme ujore, dhe se reagimet e qeverisjes duhet të evoluojnë me ndryshimin e rrethanave.

Parimet janë të rrënjosura në themele më të gjera të qeverisjes së mirë: legjitimiteti, transparencja, llogaridhënia, të drejtat e njeriut, sundimi i ligjit dhe përfshirja. Si të tilla, ato e konsiderojnë qeverisjen e ujit si një *mjet* për arritjen e një *qëllimi përfundimtar*, jo si qëllim në vetëvete, d.m.th. si gamën e rregullave politike, institucionale dhe administrative, praktikave dhe proceseve (formale dhe joformale) përmes të cilave: merren dhe zbatohen vendimet; aktorët mund të artikulojnë interesat e tyre të bindur se shqetësimet e tyre do të merren parasysh; si dhe garantohet përgjegjësia e vendimmarrësve për menaxhimin e ujit.

Parimet kanë për qëllim të përmirësojnë sistemet e qeverisjes së ujërave të cilat ndihmojnë në menaxhimin e ujërave "të tepërt", "të pakët" dhe "shumë të ndotur", në mënyrë të qëndrueshme, të integruar dhe gjithëpërfshirëse, me një kosto të pranueshme, dhe në një afat kohor të arsyeshëm. Ato konsiderojnë se qeverisja është *e mirë* nëse ndihmon në zgjidhjen e sfidave kryesore të ujit, duke përdorur një kombinim të proceseve nga poshtë-lart dhe nga lartë-poshtë, ndërsa nxiten marrëdhëniet konstruktive ndërmjet shtetit dhe shoqërisë. Ajo është *e keqe* nëse gjeneron kosto të panevojshme të transaksionit dhe nëse nuk i përgjigjet nevojave vendore.

Parimet konsiderojnë se sistemet e qeverisjes së ujërave (pak a shumë formale, komplekse dhe të kushtueshme) duhet të projektohen në përputhje me sfidat që kërkohet të adresohen. Kjo qasje për zgjidhjen e problemeve nënkupton se "format" e qeverisjes së ujërave duhet të ndjekin "funksionet" e qeverisjes së ujërave. Strukturimi, institucionalizimi dhe/ose formalizimi i institucioneve nuk duhet të devijojnë nga objektivi final për të ofruar ujë të mjaftueshëm me cilësi të mirë, ndërsa mirëmbahet dhe përmirësohet integriteti ekologjik i mjedisve ujore.

### Si janë zhvilluar parimet e OBZHE-së mbi qeverisjen e ujërave?

OBZHE udhëhoqi grupin tematik mbi "Qeverisjen e Mirë" në Forumin e 6-të Botëror mbi Ujërat (Marsejë, mars 2012). Si pjesë e procesit përgatitor të Forumit, u krijua një komunitet praktikantësh me mbi 300 aktorë, për të organizuar nëntë seanca tematike. Diskutimet mbi qeverisjen në Marsejë, u përmbyllën duke theksuar nevojën për udhëzime strikte politike, për të siguruar një kuadër të përbashkët referues për qeveritë në të gjitha nivelet, në mbështetje të qeverisjes dhe politikave më të mira për ujërat.


Në vijim, më 27-28 mars 2013, u krijua Iniciativa e OBZHE-së për Qeverisjen e Ujërave<sup>1</sup> (IQU), si një platformë shumë-aktorëshe, me mbi 100 delegatë nga sektori publik, privat dhe jofitimprurës, të cilët do të mbledhen çdo gjashtë muaj në një Forum politikash. Që atëherë, IQU ka investuar përpjekje të mëdha për të siguruar vazhdimësi dhe veprime kolektive për të fuqizuar reagimet qeverisëse ndaj sfidave të ujërave.

<sup>1</sup> <http://www.oecd.org/cfe/regional-policy/water-governance-initiative.htm>



## Objektivat dhe Koordinatorët e Forumit të 6-të Botëror për Qeverisjen e Ujërave (Mars 2012)

	<p><b>Objektivi 1</b> Deri në vitin 2015, 50% e vendeve do të kenë miratuar mekanizma konsultimi, pjesëmarrjeje dhe koordinimi që i mundësojnë aktorëve të nivelit lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar që të kontribuojnë efektivisht në vendimmarrje, në mënyrë koherente, holistike dhe të integruar. Deri në vitin 2021, 100% e vendeve do ta kenë realizuar këtë. <a href="#">Klikoni për të shkarkuar Raportin përmbledhës të Objektivit 1</a></p>
	<p><b>Objektivi 2:</b> Deri në vitin 2015, 50% e vendeve do të kenë forcuar kornizat rregullatore dhe do të kenë miratuar treguesit e performancës (të ofrimit të shërbimeve) për monitorimin dhe vlerësimin e politikave të ujit; dhe të gjitha vendet do të kenë hartuar proceset e ndërtimit të kapaciteteve në nivel kombëtar dhe lokal, për të nxitur mirëqeverisjen në ofrimin e shërbimeve. Deri në vitin 2018, të gjitha vendet do ta kenë realizuar këtë. <a href="#">Klikoni për të shkarkuar Raportin përmbledhës të Objektivit 2</a></p>
	<p><b>Objektivi 3</b> Deri në vitin 2021, numri i planeve të menaxhimit të baseneve lumore (analiza e gjendjes fillestare dhe çështjet kryesore) do të jetë rritur me 30%. <a href="#">Klikoni për të shkarkuar Raportin përmbledhës të Objektivit 3</a></p>
	<p><b>Objektivi 4</b> Deri në vitin 2015, numri i vendeve me mjete/instrumente të diagnostifikimit të sigurisë dhe qeverisjes së ujërave, bazuar në kornizat ekzistuese rregullatore dhe ligjore (lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare) dhe në mekanizmat e MIBU, do të jetë rritur. <a href="#">Klikoni për të shkarkuar Raportin përmbledhës të Objektivit 4</a></p>
	<p><b>Objektivi 5</b> Deri në vitin 2018, 30 vende do të jenë angazhuar në promovimin e integritetit në sektorin e ujërave, në diagnostifikimin/identifikimin e rreziqeve ekzistuese ose të mundshme të korrupsionit, dhe në garantimin që politikat kundër korrupsionit janë zbatuar mirë dhe janë efektive. <a href="#">Klikoni për të shkarkuar Raportin përmbledhës të Objektivit 5</a></p>
	<p><b>Objektivi 6</b> Deri në vitin 2018, 30 vende do të zbatojnë: procese transparente të hartimit të buxhetit të ujit, duke përfshirë informacion mbi planifikimin dhe zbatimin e investimeve në infrastrukturën e ujit (ndikimet financiare, teknike, dhe socio-ekonomike); dhe metodat dhe mjetet për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies në sektorin e ujit. <a href="#">Klikoni për të shkarkuar Raportin përmbledhës të Objektivit 6.</a></p>



Një hap paraprak për zhvillimin e Parimeve konsistoi në përgatitjen e inventarit të mjeteve, udhëzimeve dhe parimeve mbi qeverisjen e ujit për të shfrytëzuar gjithçka që tashmë ekziston.<sup>2</sup>

Ky dokument përbëhet nga 108 instrumente të qeverisjes, ndër të cilat 55 janë specifike për sektorin e ujit. Ato variojnë nga instrumentet vullnetare dhe të detyrueshme ndërkombëtare, deri tek një gamë e gjerë e iniciativave dhe programeve, udhëzimeve, manualeve dhe instrumenteve praktike. Inventari është i strukturuar rreth çështjeve të angazhimit të aktorëve; performancës dhe qeverisjes së furnizimit me ujë dhe kanalizime; qeverisjes së baseneve; si dhe integritetit dhe transparencës.

Ky ushtrim inventarizues ka hedhur dritë mbi vlerën e shtuar të zhvillimit të Parimeve të OBZHE-së, që do të sigurojnë një kornizë sistemike për të identifikuar dhe trajtuar boshllëqet e qeverisjes së ujërave, duke u mbështetur në praktikatat më të mira ndërkombëtare.

<sup>2</sup> <http://www.oecd.org/gov/regional-policy/Inventory.pdf>

Parimet mbi Qeverisjen e Ujërave janë zhvilluar dhe diskutuar përmes një procesi shumë-aktorësh nga poshtë-lart brenda IQU, nën kujdesin dhe drejtimin e Komitetit të Politikave të Zhvillimit Rajonal të OBZHE-së dhe në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Rregullues të Politikave të OBZHE-së dhe rrjetit të tij të Rregullatorëve Ekonomikë. Përveç kësaj, u zhvillua një konsultim i gjerë në një varg komitetesh dhe organesh ndihmëse të OBZHE-së, duke përfshirë Komitetin e Politikave të Mjedisit dhe Grupin e tij të Punës mbi Biodiversitetin, Ujërat dhe Ekosistemet, Komitetin për Qeverisje Publike dhe Grupin e tij të Punës mbi Integritetin e Zyrtarëve të Lartë Publik, Komitetin e Asistencës për Zhvillim, Komitetin e Investimeve dhe Komitetin e Bujqësisë.



Parimet u diskutuan në takimin e 33-të të Komitetit të Politikave të Zhvillimit Rajonal, më 29-30 prill 2015, dhe u miratuan nga Komiteti përmes procedurës me shkrim, më datë 11 maj 2015. Këshilli i OBZHE-së mirëpriti Parimet më 13 maj 2015 dhe pranoi t'i përcjellë tek Ministrat, të cilët i mbështetën parimet në takimin e Këshillit, në nivel ministror, më datë 4 qershor 2015.



## Parimet e OBZHE-së mbi qeverisjen e ujërave

Parimet e OBZHE-së mbi qeverisjen e ujërave ofrojnë një kuadër për të kuptuar nëse sistemet e qeverisjes së ujërave janë duke funksionuar në mënyrë optimale si dhe ndihmojnë për t'i rregulluar ato kur paraqitet e nevojshme. Ato nxisin përpjekjet për t'i bërë praktikatat e mira më të dukshme, për të mësuar nga përvojat ndërkombëtare, si dhe për të vënë në lëvizje proceset reformuese në të gjitha nivelet e qeverisjes, për të lehtësuar ndryshimin ku dhe kur është e nevojshme. Gjithashtu, ato mund të ndihmojnë në shmangien e të papriturave dhe kurtheve, duke mësuar nga përvojat ndërkombëtare.

Parimet bazohen në konsideratat e mëposhtme:

- Përballja me sfidat aktuale dhe të ardhshme, kërkon politika të forta publike dhe vendosjen e objektivave të matshëm në afate kohore të parapërcaktuara në shkallën e duhur, duke u mbështetur në ndarjen e qartë të detyrave mes të gjithë autoriteteve përgjegjëse, si dhe duke ia nënshtruar veprimtarinë e tyre monitorimit dhe vlerësimit të rregullt.
- Qeverisja efektive, efikase dhe gjithëpërfshirëse e ujërave kontribuon në hartimin dhe zbatimin e politikave të tilla, përmes ndarjes së përgjegjësisë në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe në bashkëpunim me akorët e duhur, për të tejkaluar sfidat aktuale dhe të ardhshme të ujit.
- Nuk mund të ekzistojë një përgjigje politike uniforme ndaj sfidave të ujit në mbarë botën, duke marrë parasysh diversitetin e rrethanave brenda dhe mes vendeve për sa i përket kornizave ligjore dhe institucionale, praktikave kulturore, kushteve klimatike, gjeografike dhe ekonomike prej nga ku e kanë prejardhjen sfidat e ndryshme të ujërave dhe përgjigjet/reagimet politike.
- Prandaj, për ata që janë të interesuar, qofshin anëtarë apo jo, është e përshtatshme të përdorin këto parime për të hartuar dhe zbatuar politikatat e tyre kombëtare, duke marrë parasysh rrethanat specifike të vendit.
- Qeverisja e ujërave është një komponent i rëndësishëm i kuadrit të përgjithshëm të politikave të ujërave; parimet më bazike të qeverisjes së mirë zbatohen edhe në sektorin e ujërave, dhe rezultatet e qeverisjes së ujërave mund të jenë të kushtëzuara nga përparimi në fusha të tjera të kuadrit të politikave të ujërave.
- Këto parime janë të rëndësishme për të gjitha nivelet e qeverisjes dhe mund të shpërndahen gjerësisht brenda shteteve të interesuara anëtare dhe joanëtare.
- OBZHE mund të ndihmojë shtetet e interesuara anëtare dhe joanëtare në arritjen e këtyre standardeve dhe në identifikimin e praktikave më të mira. Në vijim të punës së tij, Komiteti i Politikave të Zhvillimit Rajonal do të bëjë propozimet e nevojshme për ndjekjen dhe zbatimin e parimeve.
- Këto parime do të merren parasysh gjatë veprimtarisë së ardhshme të OBZHE-së në lidhje me ujërat.

Parimet zbatohen për ciklin gjithëpërfshirës të politikave të ujërave dhe duhet të implementohen në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse.

Si të tilla, ato nuk bëjnë dallime mes:

- *funksioneve* të menaxhimit të ujit (p.sh. furnizimi me ujë të pijshëm, kanalizimi, mbrojtja nga përmbytjet, cilësia e ujit, ujërat e shiut, ujërat e stuhive);
- *përdorimeve* të ujit (p.sh. për nevoja familjare, për industri, bujqësi, energji dhe mjedis), dhe
- *përkatësisë* së menaxhimit të ujit, burimeve dhe aseteve (p.sh. publike, private, të përziera).



© cidepix/Shutterstock.com

## Rritja e *efektshmërisë* së qeverisjes së ujërave

**Parimi 1. Ndani dhe dalloni në mënyrë të qartë rolet dhe përgjegjësitë për politikëbërjen e ujërave, zbatimin e politikave, menaxhimin dhe rregullimin operacional, si dhe nxisni koordinimin ndërmjet këtyre autoriteteve përgjegjëse.**

Për këtë qëllim, kuadri ligjor dhe institucional duhet që:

- a) Ta specifikojë ndarjen e roleve dhe përgjegjësi në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe mes institucioneve që merren me ujin, në lidhje me ujin:
  - Politikëbërjen e ujërave, veçanërisht caktimin e prioriteteve dhe planifikimin strategjik;
  - Zbatimin e politikave të ujërave, veçanërisht financimin dhe buxhetimin, të dhënave dhe informacionin, angazhimin e aktorëve, zhvillimin e kapaciteteve dhe vlerësimin e tyre;
  - Menaxhimin operacional të ujërave, veçanërisht ofrimin e shërbimeve, operimin e infrastrukturës dhe investimet;
  - Rregullimin dhe ligjzbatimin, veçanërisht caktimin e tarifave, standardeve, licencimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen, kontrollin dhe auditimin, si dhe menaxhimin e konflikteve;
- b) Të ndihmojë në identifikimin dhe adresimin e mangësive/boshllëqeve, mbivendosjeve dhe konflikteve të interesit përmes koordinimit efektiv në të gjitha nivelet e qeverisjes.

**Parimi 2. Menaxhoni ujërat në nivelin (-et) e duhur brenda sistemeve të integruara të qeverisjes së baseneve duke pasqyruar kushtet lokale dhe nxitur koordinimin ndërmjet niveleve të ndryshme.**

Për këtë qëllim, praktikatat dhe mjetet e menaxhimit të ujërave duhet që:

- a) T'i përgjigjen objektivave afatgjata mjedisore, ekonomike dhe sociale, me qëllim përdorimin më të mirë të burimeve ujore, përmes parandalimit të rrezikut dhe menaxhimit të integruar të burimeve ujore;
- b) Të inkurajojnë menaxhimin e shëndoshë të ciklit hidrologjik, nga depozitimi dhe shpërndarja e ujërave të ëmbla deri tek shkarkimi i ujërave të zeza dhe rrjedhat/flukset e kthimit;
- c) Të promovojnë strategji përshtatëse dhe lehtësuese, programe dhe masa veprimi në bazë të mandateve të qarta dhe koherente, përmes planeve efektive të menaxhimit të baseneve që janë në përputhje me politikatat kombëtare dhe kushtet lokale;
- d) Të promovojnë bashkëpunimin shumë-nivelësh ndërmjet përdoruesve, aktorëve dhe niveleve të qeverisjes për menaxhimin e burimeve ujore;
- e) Të përmirësojnë bashkëpunimin mes brigjeve në përdorimin e burimeve të ujërave të ëmbla ndërkufitare.

**Parimi 3. Inkurajoni koherencën e politikave përmes bashkëpunimit efektiv ndërsektorial, sidomos mes politikave të ujërave dhe politikave të mjedisit, shëndetësisë, energjisë, bujqësisë, industrisë, planifikimit hapësinor dhe përdorimit të tokës, përmes:**

- a) Inkurajimit të mekanizmave të koordinimit, për të lehtësuar politikatat koherente në të gjitha ministrinë, agjencitë publike dhe nivelet e qeverisjes, duke përfshirë edhe planet ndërsektoriale;
- b) Nxitjes së menaxhimit të koordinuar të përdorimit, mbrojtjes dhe pastrimit të burimeve ujore, duke marrë parasysh politikatat që ndikojnë në disponueshmërinë, cilësinë dhe kërkesën e ujërave (p.sh. në bujqësi, pylltari, miniera, energji, peshkim, transport, rekreacion dhe navigacion), si dhe parandalimin e rrezikut;
- c) Identifikimit, vlerësimit dhe adresimit të barrierave ndaj koherencës së politikave, bazuar në praktikatat, politikatat dhe rregulloret brenda dhe jashtë sektorit të ujërave, duke monitoruar, raportuar dhe rishikuar;
- d) Sigurimit të stimujve dhe rregullave për të zbutur konfliktet mes strategjive sektoriale, duke harmonizuar këto strategji me nevojat e menaxhimit të ujërave dhe duke gjetur zgjidhje që përshtaten me qeverisjen lokale dhe normat ekzistuese.

**Parimi 4. Përshtatni nivelin e kapacitetit të autoriteteve përgjegjëse me kompleksitetin e sfidave të ujërave që duhet të tejkalohen, si dhe me paketën e kompetencave të nevojshme për të kryer detyrat e tyre, përmes:**

- a) Identifikimit dhe trajtimit të boshllëqeve të kapaciteteve për zbatimin e menaxhimit të integruar të burimeve ujore, sidomos për planifikimin, vendosjen e rregullave, menaxhimin e projekteve, financat, buxhetimin, mbledhjen dhe monitorimin e të dhënave, menaxhimin e rrezikut dhe vlerësimin e tij;

- b) Përputhjes së nivelit të kapaciteteve teknike, financiare dhe institucionale në sistemet e qeverisjes të ujërave me natyrën e problemeve dhe nevojave me të cilat përballen;
- c) Inkurajimit të caktimit të kompetencave në mënyrë evolutive dhe përshtatëse, pasi demonstrohen kapacitetet e nevojshme dhe kur konsiderohet e arsyeshme;
- d) Promovimit të punësimit të zyrtarëve publikë dhe profesionistëve të ujërave duke u bazuar në meritokraci, përmes proceseve transparente të pavarur nga ciklet politike;
- e) Promovimit të arsimimit dhe trajnimit të profesionistëve të ujërave për forcimin e kapaciteteve të institucioneve dhe aktorëve të ujit në përgjithësi, si dhe për të nxitur bashkëpunimin dhe shkëmbimin e njohurive/dijes.

### **Rritja e *efikasitetit* të qeverisjes së ujërave**

**Parimi 5. Prodhoni, përditësoni dhe shkëmbeni në kohën e duhur, të dhëna dhe informata të qëndrueshme dhe të krahasueshme lidhur me ujërat dhe politikat e ujërave, dhe përdorini ato për të udhëhequr, vlerësuar dhe përmirësuar politikat e ujërave, përmes:**

- a) Përcaktimit të kërkesave të prodhimit të qëndrueshëm dhe kosto-efektiv, si dhe metodave për shkëmbimin e të dhënave dhe informatave të cilësisë së lartë lidhur me ujërat, p.sh. mbi gjendjen e burimeve ujore, financimin e ujërave, nevojat mjedisore, karakteristikat socio-ekonomike dhe planifikimin institucional;
- b) Nxitjes së koordinimit efektiv dhe shkëmbimit të përvojave midis organizatave dhe agjencive që prodhojnë të dhëna lidhur me ujërat, mes prodhuesve dhe përdoruesve të të dhënave, dhe në të gjitha nivelet e qeverisjes;
- c) Promovimit të angazhimit të aktorëve në projektimin dhe zbatimin e sistemeve të informacionit mbi ujërat, si dhe ofrimin e udhëzuesve mbi mënyrën si duhet të shkëmbet ky informacion, për të nxitur transparencën, mirëbesimin dhe krahasueshmërinë (p.sh. databazat, raportet, hartat, diagramet, observatorët);
- d) Inkurajimin për të projektuar sisteme të harmonizuara dhe të qëndrueshme informacioni në nivel basenesh, duke përfshirë edhe rastet e ujërave ndërkuftare, për të nxitur besimin reciprok, reciprocitetin dhe krahasueshmërinë brenda kornizës së marrëveshjeve mes vendeve ndërkuftare;
- e) Rishikimit të procesit të mbledhjes së të dhënave, përdorimit, shkëmbimit dhe shpërndarjes për të identifikuar mbivendosjet dhe sinergjitë, si dhe për të gjurmuar mbingarkesën e panevojshme të të dhënave.

**Parimi 6. Garantoni që masat qeverisëse ndihmojnë në organizimin e financave të ujërave dhe në ndarjen e burimeve financiare në mënyrë efektive, transparente dhe në kohën e duhur, përmes:**

- a) Nxitjes së masave qeverisëse që ndihmojnë institucionet e ujërave në të gjitha nivelet e qeverisjes që të rrisin të ardhurat e nevojshme për të përmbushur detyrat e tyre, për shembull, duke u bazuar mbi parime të tilla si, "ndotësi paguan" dhe "përdoruesi paguan", si dhe përmes pagesave për shërbimet mjedisore;
- b) Kryerjes së analizave sektoriale dhe planifikimit strategjik financiar për të vlerësuar investimet dhe nevojat operacionale afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, si dhe për të ndërmarrë masa për të siguruar disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e financave të tilla;
- c) Miratimit të praktikave të shëndosha dhe transparente për buxhetimin dhe kontabilitetin, praktika të cilat ofrojnë një pasqyrë të qartë të aktiviteteve të ujërave dhe të gjitha detyrimeve shoqëruese sipas rastit, duke përfshirë investimet në infrastrukturë, përafrimin e planeve strategjike shumëvjeçare me buxhetet vjetore dhe prioritetet afatmesme të qeverive;
- d) Miratimit të mekanizmave që nxisin ndarjen efektive dhe transparente të fondeve publike në lidhje me ujërat (p.sh. përmes kontratave sociale, arritjes së objektivave dhe auditimeve);
- e) Minimizimit të ngarkesave të panevojshme administrative në lidhje me shpenzimet publike duke ruajtur masat mbrojtëse fiskale dhe ato të mirëbesimit.

**Parimi 7. Garantoni që kornizat e shëndosha rregullatore mbi menaxhimin e ujërave zbatohen në mënyrë efektive dhe në përputhje me interesin publik, përmes:**

- a) Garantimit të një kuadri ligjor dhe institucional të plotë, koherent dhe të parashikueshëm, që përcakton rregulla, standarde dhe udhëzime për arritjen e rezultateve të politikave të ujërave, dhe që inkurajon planifikimin e integruar afatgjatë;
- b) Garantimit që funksionet kryesore rregullatore janë organizuar në të gjitha agjencitë publike, institucionet e dedikuara dhe nivelet e qeverisjes dhe që autoritetet rregullatore janë të pajisura me burimet e nevojshme;
- c) Garantimit që rregullat, institucionet dhe proceset janë të mirëkoordinuara, transparente, jodiskriminuese, lejojnë pjesëmarrjen dhe janë të lehta për t'u kuptuar dhe zbatuar;
- d) Inkurajimit të përdorimit të mjeteve rregullatore (mekanizme të vlerësimit dhe konsultimit) për të përmirësuar cilësinë e proceseve rregullatore dhe, kur është e përshtatshme, për t'i bërë rezultatet të hapura për publikun;
- e) Përcaktimit të rregullave, procedurave, stimujve dhe instrumenteve të qarta, transparente dhe proporcionale për të imponuar zbatimin (duke përfshirë shpërblimet dhe ndëshkimet), për të nxitur pajtueshmërinë dhe për të arritur objektivat rregullatore në mënyrë kosto-efektive;
- f) Garantimit të mundësive për të kërkuar kompensim/dëmshpërblim efektiv përmes qasjes jodiskriminuese në institucionet e drejtësisë, duke pasur parasysh gamën e opsioneve në dispozicion.

**Parimi 8. Promovoni miratimin dhe zbatimin e praktikave inovative të qeverisjes së ujërave në të gjitha autoritetet përgjegjëse, nivelet e qeverisjes dhe aktorët përkatës, përmes:**

- a) Inkurajimit të eksperimentimit dhe pilot-testimit në qeverisjen e ujërave, duke nxjerrë mësim nga sukseset dhe dështimet, dhe duke i shtuar praktikatat e ripërsëritshme;
- b) Promovimit të të mësuarit social për të lehtësuar vendosjen e dialogut dhe arritjen e konsensusit, për shembull, përmes platformave të rrjetëzimit, mediave sociale, teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK-ave) dhe ndërfaqeve lehtësisht të përdorshme (p.sh. hartat digjitale, të dhënat e mëdha, të dhënat e zgjuara dhe të dhënat e hapura) dhe mjeteve të tjera;
- c) Promovimit të mënyrave inovative për të bashkëpunuar, për të bashkuar burime dhe kapacitete, për të ndërtuar sinergji mes sektorëve dhe për të kërkuar rritje të efikasitetit, kryesisht nëpërmjet qeverisjes metropolitane, bashkëpunimit ndërkomunal, partneriteteve urbane-rurale, dhe kontratave të bazuara në performancë;
- d) Promovimit të një ndërfaqeje të fortë mes shkencës dhe politikave për të kontribuar në një qeverisje më të mirë të ujërave dhe për të kapërcyer hendekun ndërmjet zbulimeve shkencore dhe praktikave të qeverisjes së ujërave.

**Rritja e mirëbesimit dhe angazhimit në qeverisjen e ujërave**

**Parimi 9. Fuqizoni praktikatat e integritetit dhe transparencës në politikat e ujërave, institucionet ujore dhe kornizat e qeverisjes së ujërave, për llogaridhënie dhe mirëbesim më të madh në vendimmarrje, përmes:**

- a) Promovimit të kornizave ligjore dhe institucionale që i bëjnë vendimmarrësit dhe aktorët më të përgjegjshëm, të tilla si e drejta për informim dhe hetimi i çështjeve që lidhen me ujërat dhe zbatimin e ligjit nga autoritete të pavarura;
- b) Inkurajimit të normave, kodeve të sjelljes ose kartave mbi integritetin dhe transparencën në kontekstet kombëtare ose lokale dhe monitorimin e zbatimit të tyre;
- c) Përcaktimit të mekanizmave të qartë të llogaridhënies dhe kontrollit për të garantuar transparencë në hartimin dhe zbatimin e politikave;
- d) Diagnostifikimit dhe identifikimit të rregullt të faktorëve ekzistues ose të mundshëm që nxisin korrupsionin dhe rreziqet në të gjitha institucionet e shërbimeve ujore në nivele të ndryshme, duke përfshirë edhe prokurimin publik;

- e) Miratimit të qasjeve që garantojnë përfshirjen e shumë aktorëve, mjete të dedikuara dhe plane veprimi për të identifikuar dhe trajtuar boshllëqet e integritetit dhe transparencës së ujërave (p.sh. ekzaminimi/paktet e integritetit, analiza e rrezikut, dëshmitarët social).

**Parimi 10. Promovoni angazhimin e aktorëve për të garantuar kontribute të bazuara në informacione dhe të orientuara drejt rezultateve për hartimin dhe zbatimin e politikave të ujërave, përmes:**

- a) Identifikimit dhe kategorizimit të aktorëve publikë, privatë dhe jofitimprurës që janë të interesuar për rezultatin apo që me gjasë preken nga vendimet në lidhje me ujërat, përfshi përgjegjësitë e tyre, motivet kryesore dhe ndërveprimet;
- b) Kushtimit të vëmendjes ndaj kategorive të papërfaqësuar (të rinjve, të varfërve, grave, popujve indigjen, përdoruesve të brendshëm), të sapoardhurve (zhvilluesve të pronave, investitorëve institucional) dhe aktorëve dhe institucioneve të tjera që kanë të bëjnë me ujërat;
- c) Përcaktimit të kufirit mes vendimmarrjes dhe përdorimit të pritshëm të inputeve të aktorëve, përfshi zbutjen e çekuilibrave të pushtetit dhe rreziqeve të përqendrimit të konsultimeve në kategoritë e mbipërfaqësuar ose më të zëshme, si dhe ndërmjet zërave të ekspertëve dhe joekspertëve;
- d) Inkurajimit të zhvillimit të kapaciteteve të aktorëve përkatës si dhe, sipas nevojës, informacioneve të sakta, në kohë dhe të besueshme;
- e) Vlerësimit të procesit dhe rezultateve të angazhimit të aktorëve për të mësuar, rregulluar dhe përmirësuar në përputhje me rrethanat, duke përfshirë edhe vlerësimin e kostove dhe përfitimeve të këtij procesi;
- f) Promovimit të kornizave ligjore dhe institucionale, strukturave organizative dhe autoriteteve përgjegjëse që favorizojnë angazhimin e aktorëve, duke marrë parasysh rrethanat lokale, nevojat dhe kapacitetet;
- g) Përshtatjes së llojit dhe nivelit të angazhimit të aktorëve me nevojat ekzistuese dhe ruajtjes së fleksibilitetit të procesit për t'iu përshtatur rrethanave të ndryshueshme.

**Parimi 11. Inkurajoni kornizat e qeverisjes së ujërave të cilat ndihmojnë në menaxhimin e kompromiseve mes përdoruesve të ujit, brezave si dhe zonave rurale e urbane, përmes:**

- a) Promovimit të pjesëmarrjes jodiskriminuese në vendimmarrje për të gjithë njerëzit, veçanërisht të grupeve të cenueshme dhe njerëzve që jetojnë në zonat e largëta;
- b) Fuqizimit të autoriteteve dhe përdoruesve lokalë, për të identifikuar dhe trajtuar barrierat ndaj aksesimit të shërbimeve dhe burimeve cilësore të ujit, si dhe promovimi i bashkëpunimit rural-urban, përfshi fuqizimin e partneritetit mes institucioneve të ujit dhe planifikuesve hapësinorë;
- c) Promovimit të debatit publik mbi rreziqet dhe kostot që shoqërojnë ujin e tepërt, të paktë ose shumë të ndotur, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit, arritjes së konsensusit mbi atë se kush paguan për çfarë, dhe për të kontribuar për përbalueshmëri dhe qëndrueshmëri më të mirë, tani dhe në të ardhmen;
- d) Inkurajimit të vlerësimit të bazuar në prova mbi pasojat e politikave në shpërndarjen e ujit tek qytetarët, përdoruesit e ujit dhe vendet, për të udhëzuar dhe përmirësuar vendimmarrjen.

**Parimi 12. Promovoni monitorimin dhe vlerësimin e rregullt të politikave dhe qeverisjes së ujërave, aty ku është e përshtatshme, ndani rezultatet me publikun dhe kryeni rregullime kur është e nevojshme, përmes:**

- a) Promovimit të institucioneve të dedikuara për monitorim dhe vlerësim, të cilat janë të pajisura me kapacitete të mjaftueshme, shkallën e duhur të pavarësisë dhe burimeve, si dhe me instrumentet e nevojshme;
- b) Zhvillimit të mekanizmave të besueshëm të monitorimit dhe raportimit, për të udhëhequr në mënyrë efektive vendimmarrjen;
- c) Vlerësimit së deri në çfarë mase politikave të ujërave përmbushin rezultatet e synuara dhe nëse kornizat e qeverisjes së ujërave janë të përshtatshme për këtë qëllim;
- d) Inkurajimit të shkëmbimit të rezultateve të vlerësimit në mënyrë transparente dhe në kohë, si dhe përshtatja e strategjive bazuar në informacionin e ri në dispozicion.

## Deklarata Shumë-Aktorëshe e Daegut mbi Parimet

Deklarata Shumë-Aktorëshe e Daegut mbi Parimet e OBZHE-së mbi Qeverisjen e Ujërave është një rezultat konkret i qasjes shumë-aktorëshe, që mbështet zhvillimin e Parimeve. Ajo iu dorëzua Sekretarit të Përgjithshëm të OBZHE-së, Angel Gurría, në Forumin e 7-të Botëror të Ujërave, më datë 13 prill 2015.



### Deklarata Shumë-Aktorëshe e Daegut mbi Parimet e OBZHE-së për Qeverisjen e Ujërave

Ne, organizata nga sektori publik, privat dhe jofitimprurës, grupe të mëdha interesi dhe individë, të angazhuar në mënyrë aktive në Iniciativën e OBZHE-së për Qeverisjen e Ujërave (IOU), një rrjet inovativ i aktorëve të shumtë, i përbërë prej mbi 120 delegatë, të cilët mbledhen dy herë në vit në Forumin e Politikave, fuqimisht besojmë se krizat e ujit janë shpesh kriza të qeverisjes, prandaj:

1. **Plotësisht mbështesim Parimet e OBZHE-së mbi Qeverisjen e Ujërave** si një kornizë solide për të ndihmuar qeveritë kombëtare dhe rajonale në hartimin dhe zbatimin e politikave më të mira të ujërave, për jetë më të mirë, në bashkëpunim me spektrin e gjerë të aktorëve brenda dhe jashtë sektorit të ujërave;
2. **Përhëndesim proceset nga poshtë-lart, proceset shumë-aktorëshe dhe gjithëpërfshirëse** që qëndrojnë pas përgatitjes së Parimeve që prej krijimit të Iniciativës së Qeverisjes së Ujërave më 27 mars të vitit 2013, si një vazhdimësi e angazhimit të OBZHE-së në Forumin e 6-të Botëror të Ujërave (Marsejë, 2012);
3. **U bëjmë thirrje qeverive nga vendet e OBZHE-së që t'i miratojnë Parimet** në takimin e 33-të të Komitetit të Politikave të Zhvillimit Rajonal, më 29 prill 2015, dhe t'u japin atyre një nxitje të fortë dhe të nivelit të lartë politik në takimin e Këshillit Ministror të OBZHE-së, më 3-4 qershor 2015;
4. **Presim integrimin e Parimeve në një Rekomandim të OBZHE-së** për t'ui dhënë atyre natyrë ligjore dhe mbështetje morale të fuqishme, dhe për të siguruar një bazë konsensuale për të identifikuar dhe fuqizuar praktikatat më të mira me qëllim nxitjen e ndryshimeve në qeverisje dhe politika;
5. **Ftojme vendet në zhvillim që të mbështesin Parimet** dhe që t'i përmbahen Rekomandimit që do të pasojë;
6. **Zotohemi që të gjithë aktorët do të përdorin Parimet për të udhëhequr aktivitetet dhe praktikatat e tyre** për të forcuar efektivitetin, efikasitetin, besimin dhe angazhimin në qeverisjen e ujërave;
7. **Përkushtohemi që t'i shpërndajmë Parimet gjerësisht brenda organizatave tona, tek anëtarët, rrjetet, partnerët dhe publiku në përgjithësi;**
8. **Ftojme OBZHE-në që të zhvillojë treguesit e qeverisjes së ujërave**, me të njëjtin proces gjithëpërfshirës dhe nga poshtë-lart, për të monitoruar progresin në zbatimin e Parimeve, veçanërisht në kontekstin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm;
9. **Presim që Iniciativa e Qeverisjes së Ujërave të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm në shtimin e përvojës ndërkombëtare për të lehtësuar krahasimin dhe mësimin nga kolegët, në secilin prej Parimeve;**
10. **Falënderojmë OBZHE-në për angazhimin dhe udhëheqjen**, duke qenë të gatshëm të kontribuojmë në përpjekjet e ardhshme kolektive në mbështetje të mirëqeverisjes në sektorin e ujërave.

Këtu mund të shikoni Deklaratën online: <http://www.oecd.org/gov/regional-policy/world-water-forum-7.htm>

Gjatë seancës, paneli i nivelit të lartë i kryesuar nga Peter Glas (Kryetar, Iniciativa e OBZHE-së për Qeverisje të Ujërave) ishte i përbërë nga Jeong Yeon-man (Zëvendësministër i Mjedisit, në Kore), Jean-Louis Chaussade (Kryeshefi Ekzekutiv, Suez Environnement), Francisco Nunes-Correia (President, Portuguese Water Partnership), Célia Blauel (President, Aqua Publica Europea), dhe Joppe Cramwinckel (Drejtor i ujit, World Business Council on Sustainable Development). Panelistët i përshëndetën Parimet e OBZHE-së si një pikënisje dhe një kornizë e vlefshme, që mund të shërbejë si një busull për vendimmarrësit dhe praktikuesit, drejt një qeverisjeje efektive, efikase dhe gjithëpërfshirëse të ujërave.

Deklarata përmban 65 nënshkrime nga organizata të sektorit publik, privat dhe jofitimprurës, grupe të mëdha të aktorëve dhe individë, të angazhuar në mënyrë aktive në Iniciativën e OBZHE-së për Qeverisjen e Ujërave, të cilët janë zotuar që t'i përfshijnë ato në aktivitetet dhe praktikatat e tyre dhe që të punojnë më tej me OBZHE-në për të mbështetur zbatimin e Parimeve.

## Lista e nënshkruesve




Jean-François Donzier  
Permanent Technical Secretary, INBO  
General Director, IOWater




Håkan Tropp  
Managing Director of the Knowledge Services,  
Stockholm International Water Institute




Pierre-Alain Roche  
President, ASTEE

Teun Bastemeijer  
Chief Advisor Strategy and Programmes, Water  
Integrity Network




Cobus de Swardt  
Managing Director, Transparency International




Alice Aureli  
Chief of Groundwater Section, UNESCO-IHP





Nicolle Raven

Secretary General, European Irrigation Association



Dogan Altinbilek

President, International Water Resources Association



Nidal Salim

Director General, Global Institute for Water Environment and Health




Hachmi Kennou

Executive Director, Institut Méditerranéen de l'Eau




Cecilia Tortajada

Vice President, Third World Centre for Water Management



Rui Godinho

President, Portuguese Association of Water and Wastewater Services



Lesha Witmer

Coordinator, Steering Committee member, Butterfly Effect





Keizrul Bin Abdullah  
*Chairperson, Network of Asian River Basin Organisation*



Ignacio Castelao  
*Deputy Director, AcuaMed*



Robert Varady  
*Deputy Director, Udall Center for Studies in Public Policy*



Udall Center  
for Studies in Public Policy

Sharon Megdal  
*Director, Water Resources Research Center*



THE UNIVERSITY OF ARIZONA  
College of Agriculture  
& Life Sciences  
Cooperative Extension

Gilles Trystram  
*Directeur Général, AgroParisTech*



Stefan Uhlenbrock  
*Vice Rector, UNESCO-IHE*



UNESCO-IHE  
Institute for Water Education

Ger Bergkamp  
*Executive Director, International Water Association*



Gyewoon Choi  
*Chief Executive Officer, K-water*



Henri Bégorre  
*President, Partenariat Français pour l'Eau*



Michael Scoullos  
*Chairman, Global Water Partnership Mediterranean*



Célia Blauel  
*President, Aqua Publica Europea*



EUROPEAN ASSOCIATION  
OF PUBLIC WATER OPERATORS

Rozemarijn Ter Horst  
*Coordinator, Water Youth Network*



Miguel A. Rodenas  
*President, Segura River Basin Authority - Spain*



Claude Menard  
*Professor of Economics, University of Paris*



Bai Mass Taal  
*Executive Secretary, African Ministers' Council on Water*



Roberto Olivares

*General Director, National Association of Water and Sanitation Utilities of Mexico*



Peter Glas

*President, Dutch Water Authorities*



María Ángeles Ureña Guillem

*President, Júcar River Basin Authority - Spain*



Martin Guespereau

*Director general, Agence de l'Eau Rhône Méditerranée Corse - France*



IL SEGRETARIO GENERALE  
(D.ssa Gaia Checcucci)

Gaia Checcucci

*Secretary General, Arno river Basin Authority - Italy*



Franco Becchis

*Scientific Director, Turin School of Local Regulation - Fondazione per l'Ambiente*



Neil Dhot

*Secretary General, EurEau*



*Ursula Schaefer-Preuss*

Ursula Schaefer-Preuss  
*Chair, Global Water Partnership*

Water Governance Centre Netherlands

*Corné Nijburg*  
mr. C. Nijburg  
director

Corné Nijburg  
*Director, Water Governance Centre*



*J. Carl Ganter*

J. Carl Ganter  
*Managing Director, Circle of Blue*



*Francisco Nunes Correia*

Francisco Nunes Correia  
*President, Portuguese Water Partnership*



*Fernando Morcillo*

Fernando Morcillo  
*President, Spanish Association of Water Supply and Sanitation*



*Joppe Cramwinckel*

Joppe Cramwinckel  
*Water Director, World Business Council for Sustainable Development*



*Frédéric Molossi*

Frédéric Molossi  
*President, Association française des EPTB*



Gonzalo Robles Orozco  
*Vice-President, Spanish Agency for International  
Cooperation for Development*



Philippe Maillard  
*President, FP2E*



Francisco Cabezas  
*General Director, Fundación IEA*



Luigi Carbone  
*Commissioner, Regulatory Authority for Electricity and  
Gas and Water System - Italy*



Antoine Frérot  
*CEO, Veolia*



H.F.M.W. van Rijswick  
*Professor, Utrecht University*



Jean-Louis Chaussade  
*CEO, Suez Environnement*



**Jaime Baptista**  
*President, Water and Waste Services Regulation Authority - Portugal*



Entidade Reguladora dos Serviços de Águas e Resíduos

**Xavier Ursat**  
*Member of the Governing Board, EDF*



**Geert Teisman**  
*Professor, Erasmus University*

**Erasmus University Rotterdam**



**Jennifer McKay**  
*Director, Centre for Comparative Water Policies and Laws, University of South Australia*



**Mohamed Boussraoui**

*Executive Officer, United Cities and Local Governments*



**Stefano Burchi**  
*Chairman of the Executive Council, International Association for Water Law*



**Faraj El-Awar**  
*Programme Manager, Global Water Operators Partnerships Alliance*



**Jean-Philippe Bayon**  
*Coordinator, UNDP Global Water Solidarity*



Jean Launay

*President, National Committee on Water – France*

Michel Lesage

*Deputee, French National Assembly*

Bernard Barraqué

*Emeritus Research Director, Centre International de Recherche de l'Environnement et de Développement*



Benedito Braga

*President, World Water Council*



Yasmin Sidiqqi

*Principal Water Resources Specialist, Asian Development Bank*



Gérard Mestrallet

*CEO, GDF-Suez*



Jean Lapegue

*Senior WASH Advisor, ACF-France*



Marco Lambertini

*Director General, WWF International*



## Literaturë shtesë

---

OECD (2015, i ardhshëm), *Qeverisja e Ujërave në Brazil*, Studime të OBZHE-së mbi ujërat, Botim i OBZHE-së; <http://dx.doi.org/10.1787/9789264238121-en>

OECD (2015a), *Stakeholder Engagement for Inclusive Water Governance*, OECD Studies on Water, OECD Publishing; <http://dx.doi.org/10.1787/9789264231122-en>.

OECD (2015b), *The Governance of Water Regulators*, OECD Studies on Water, OECD Publishing; <http://dx.doi.org/10.1787/9789264231092-en>.

OECD (2015c), *Water and Cities: Ensuring Sustainable Futures*, OECD Studies on Water, OECD Publishing; <http://dx.doi.org/10.1787/9789264230149-en>.

OECD (2014), *Water Governance in the Netherlands: Fit for the Future*, OECD Studies on Water, OECD Publishing; <http://dx.doi.org/10.1787/9789264102637-en>.

OECD (2014), *Water Governance in Jordan: Overcoming the challenges to private sector participation*, OECD Studies on Water, OECD Publishing; <http://dx.doi.org/10.1787/9789264213753-en>

OECD (2014), *Water Governance in Tunisia: Overcoming the challenges to private sector participation*, OECD Studies on Water, OECD Publishing; <http://dx.doi.org/10.1787/9789264174337-en>

OECD (2013), *Making Water Reform Happen in Mexico*, OECD Studies on Water, OECD Publishing; <http://dx.doi.org/10.1787/9789264187894-en>.

OECD (2012a), *OECD Environmental Outlook to 2050*, OECD Publishing; <http://dx.doi.org/10.1787/9789264122246-en>

OECD (2012b), *Water Governance in Latin America and the Caribbean: A Multi-level Approach*, OECD Studies on Water, OECD Publishing; <http://dx.doi.org/10.1787/9789264174542-en>.

OECD (2011), *Water Governance in OECD Countries: A Multi-level Approach*, OECD Studies on Water, OECD Publishing; <http://dx.doi.org/10.1787/9789264119284-en> .

## Për më shumë informacione

---

Kontaktimi me programin e qeverisjes së ujërave të OBZHE-së

Adresa elektronike: [water.governance@oecd.org](mailto:water.governance@oecd.org) – Numri i telefonit: + 33 1 45 24 76 86



Vizitoni faqen tonë të internetit: <http://www.oecd.org/regional/water>

**OECD SMEs, Regions, Cities & Tourism** ([@OECD\\_local](https://twitter.com/OECD_local) #OECDwater)



Përkthyer nga Republika e Kosovës - Këshilli Ndërmintor për Ujërat - Međuministarski odbor za vode

Botuar fillimisht nën titullin *OECD Principles on Water Governance, 2015*.

Në rast të mospërputhjeve midis versionit fillestar dhe përkthimit, vetëm teksti i versionit fillestar duhet të konsiderohet i vlefshëm.